



**RAPORT VJETOR
PËR AKTIVITETIN AFARIST TË
FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE
PËR VITIN 2021**

Shkup, shkurt 2022

Përmbajtja

I.	LËVIZJA E DEPOZITAVE BANKARE TË POPULLATËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITIT 2021	3
II.	PORTOFOLI INVESTUES I FONDIT (01.01.2021– 31.12.2021)	13
III.	KOMPENSIMI I DEPOZITUESVE TË ANËTAREVE TË FONDIT TEK TË CILËT KA NDODHUR RAST I RREZIKUT (FALIMENTIM OSE LIKUIDIM)	15
V.	AKTIVITETET AFARISTE TË FONDIT GJATË VITIT 2021.....	22
	ORGANET E MENAXHIMIT DHE UDHEHEQJA	22
	AKTET E SJELLURA.....	23
	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	26
	MARDHËNIE ME PUBLIKUN	26
	AKTIVITETE TË TJERA TË FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE	30

REZIME

Viti 2021 është i dyti, i shënuar në luftën me shmundjes ngjitëse COVID19, ky vit paraqet rimëkëmbjen graduale nga tronditja e shkaktuar në shëndetësi dhe ekonomi gjatë vitit 2020.

Përmirësimi shënohet sipas treguesëve makroekonomik për ekonominë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe atë¹: norma e rritjes së prodhimit bruto- vendor për vitin 2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut është pozitive dhe paraqet 4,1%(për vitin 2020 ishte negative dhe paraqite -6,1%); 2. norma e inflacionit shënoi rritje në vitin 2021 dhe paraqet 15,8%(për vitin 2020 paraqite 16,4%); 3. Shkalla e papunësisë në vitin 2021 paraqet 47,3%(për vitin 2020 paraqite 47,2%); 4. Rroga mesatare bruto e paguar për një të punësuar në nëntor të vitit 2021, paraqite shumë prej 43,509 denar².

Gjatë vitit 2021 vazhdoi pagesa e kompenzimeve të depozitorëve të „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim, nëpërmjet katër bankave – pagueuse. Deri më 31.12.2021, ishin të paguara 88,9%(3,76 miliardë denar) nga përlllogaritja e përgjithshme për kompenzim të „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim, për 12.424 depozitues.

Rritja e depozitave të popullatës shënoi 7,1% për vitin 2021 (2020:4,19%). Më 31.12.2021, shuma e depozitave të përgjithshme të popullsisë paraqite 316,67 miliardë denar³, prej të cilave 49,2% janë depozita në denar, ndërsa 50,8% janë depozita në deviza (valuta të huaja). Pagesa e premive në vitin 2021 zhvillohej me normë prej 0,25% në nivel vjetor. Premitë përlllogariten në bazë të lëvizjes së depozitave të përgjithshme të popullsisë.

Portofoli investues i Fondit për vitin 2021 shënoi rritje prej 807,5 milion denar gjegjësisht rritje prej 5,8% në lidhje me gjendjen e portofolit investues të datës 31.12.2020. Më 31.12.2021 gjendja e përgjithshme e e portofolit investues paraqiste 14.770 milion denar sipas vlerës nominale gjegjësisht 14.730 milion denar vlerë e tanishme. Fondi gjatë vitit 2021 morri pjesë në 14 aukcione të bonove të thesarit shtetror të Ministrisë së Financave.

Fondi, nëpërmjet lidhjes online morri pjesë në të gjitha mbledhjet e Komitetit për Madhënie me Publikun pran Forumit Evropian të Sigurimit të Depozitave (EFDI)- gjithsej 3. Si anëtarë aktiv i EFDI (Forumit Evropian i Siguruesëve të Depozitave), Fondi morri pjesë edhe në Kuvendin e rregullt vjetor të EFDI-së i cili gjithashtu u mbajtë online.

Fondi për Sigurimin e Depozitave morri pjesë në manifestimin e Ditës botërore të kursimit si organizator, bashkë me Asociacionin Bankar Maqedonas i cili u mbajtë më 30.10.2021 me prezencë fizike të pjesëmarrësive.

Drejtor,
Amir Shabani

I. LËVIZJA E DEPOZITAVE BANKARE TË POPULLATËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITIT 2021

¹ Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

² Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës


³ Depozita e përgjithshme të popullsisë paraqesin 5,13 miliard euro të përlllogarituara sipas kursit të mesëm të BPRMV më 31.12.2021

Vlera e përgjithshme e depozitave të popullatës në sektorin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të muajit dhjetor të vitit 2021 paraqiste 316,67 miliard denar⁴. Lëvizjet mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në sektorin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të treguara në Grafikonin nr.1 ose të ndara në muaj në Tabelën nr.1. Rritja vjetore e depozitave paraqet 7,10%, nga të cilat peshë më të madhe ka rritja e depozitave prej 2,12% në muajin dhjetor të vitit 2021.

Rritja prej 7,10% në nivel vjetor është më madhe se sa rritja e depozitave të popullatës e realizuar në vitin 2020 (4,19%) e cila i dedikohet rimëkëmbjes nga kriza, që erdhi si pasojë e shkaktuar nga pandemia e smundjes ngjitëse COVID19. Sipas analizave është konstatuar se depozitat e paafatizuara në dhjetor të vitit 2021 kanë rritje prej 18,7% krahasuar me të njëjtat në dhjetor të vitit 2020, ndërsa depozitat e afatizuara kanë rënie prej (-4,17%). E shprehur në përqindje depozitat e afatizuara në depozitat e përgjithshme të popullatës më 31.12.2021 marrin pjesë me 45,4% gjegjësisht depozitat e paafatizuara paraqesin 54,6%. Në aspekt të strukturës valutore, depozitat në denar kanë rritje prej 0,47% ndërsa depozitat devizore rritje prej 14,4% krahasuar me dhjetorin e vitit 2020.

Grafikoni 1. Lëvizjet mujore të depozitave të popullatës gjatë vitit 2021

(në denar)



Burimi: Të dhëna administrative të FSD

Tabela 1. Lëvizje mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në vitin 2021

(në një mijë denar)


⁴ Depozitat e përgjithshme të popullatës paraqesin 5,13 miliard euro të përlogaritura sipas kursit të mesëm të BPRMV deri më 31.12.2021

Periodha	Projektme për lëvizjen e depozitave të përgjithshme të popullatës në RMV në pajtim me Planin Financiar për vitin 2021	Projektme të rritjes mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në vitin 2021 (në përqindje)	Depozitat e përgjithshme të popullatës në RMV në vitin 2021	Rritje mujore në përqindje
31.12.2020	299.294.607	%	295.686.631	%
31.1.2021	298.097.429	-0,40	296.122.887	0,15
28.2.2021	300.780.306	0,90	299.961.877	1,30
31.3.2021	300.930.696	0,05	300.706.003	0,25
30.4.2021	302.736.280	0,60	301.169.505	0,15
31.5.2021	303.644.489	0,30	302.361.953	0,40
30.6.2021	306.073.645	0,80	303.174.255	0,27
31.7.2021	307.604.013	0,50	304.236.475	0,35
31.8.2021	308.834.429	0,40	306.964.382	0,90
30.9.2021	310.378.601	0,50	308.302.103	0,44
31.10.2021	310.999.359	0,20	308.409.608	0,03
30.11.2021	312.865.355	0,60	310.099.368	0,55
31.12.2021	317.558.335	1,50	316.667.657	2,12
Rritje vjetore		6,10		7,10

Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Gjatë vitit 2021, rritja mujore e depozitave të popullatës nuk ka lëkundje të mëdha në nivel mujor, siç ishte situata gjatë vitit paraprak, 2020, të cilat u shkaktuan si pasojë e fillimit të pandemisë dhe falimentimit të „Eurostandard bankës” SHA Shkup. Gjatë mujait janar dhe shkurt të viti 2021, rritja mujore e depozitave të popullatës paraqite 0,15% (dhjetor 2020:janar 2021) dhe 1,30% (janar 2021:shkurt 2021), në mars të vitit 2021, rritja mujore paraqite 0,25% (shkurt2021: mars 2021), ndërsa në prill të 2021 shënohet rritje prej 0,15%(mars2021: prill2021). Në muajin maj 2021, rritja e depozitave paraqet 0,40%(prill2021:maj2021), në qershor 0,27%(maj2021:qershor2021) dhe në korrik të vitit 2021 0,35% (qershor2021:korrik2021). Në gusht të vitit 2021 është shënuar rritje prej 0,90% (korrik2021:gusht2021). Pastaj, në shtator të vitit 2021 ka rritje prej 0,44% (gusht2021:shtator2021), në tetor të vitit 2021 shënohet rritje evogël prej 0,03%(shtator2021:tetor2021), në muajin nëntor 2021 ka rritje prej 0,55% (tetor2021:nëntor2021) dhe dhjetor 2021 ka rritje prej 2,12% (nëntor2021:dhjetor2021).


Grafikon 2. Rritje e depozitave sipas muajëve gjatë vitit 2021
(në përqindje)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Rritja vjetore e depozitave të përgjithshme të popullatës në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në tre vitet e fundit është treguar në Grafikonin nr.3

Grafikon 3. Rritje vjetore e depozitave 2019-2021




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Analiza e depozitave të popullatës në aspektin e strukturës valutore tregon se në janar të 2021 ka rënie të vogël prej(-0,63%), por ka rritje të depozitave devizore prej 1,01%. Në shkurt të viti 2021 shënohet rritje më e madhe e depozitave në denar prej 2,01% dhe rritje e vogël e dpozitave devizore prej 0,52% , në mars të 2021 ka rënie në rritjen e depozitave në denar prej(-0,10) ndërsa rrije në depozitat devizore prej 0,63%, në prill të viti 2021 ka rritje në depozitat në denar 0,10% dhe rritje në ato devizore prej 0,21%, në maj të 2021-të rritje në depozitat në denar prej 0,13% dhe rritje deri në 0,68% në depozitat devizore, në qershor të vitit 2021 rënie në depozitat në denar (-0,40%) dhe rritje në depozitat devizoreprej 1%, në korrik rritje prej 0,26% në depozitat në denar, gjithashtu rritje prej 0,45% edhe në depozitat devizore, në gusht të viti 2021 rritje prej 0,87% e depozitave në denar dhe rritje e depozitave devizore prej 0,92%, në shtator të 2021-të ka rënie të depozitave në denar (-0,24) dhe rritje prej 1,16% në ato devizore, në tetor ka rënie në depozitat në denar(-2,26%) dhe rritje prej 2,46% në ato devizore, në nëtor të 2021-të ka rënie në depozitat në denar (-1,58%) dhe rritje prej 2,69% në ato devizore. Ky tren i rënies tremujore i depozitave në denar dhe i rritjes së atyre në deviza është si pasojë e ndikimit të informacioneve shpekulative që qarkullonin në publik për rritjen e shpejtë të inflacionit dhe devalvimit të denarit, kur popullata filloi depozitat e veta në denar ti shëndroj në devizë(valuta të huaja). Në dhjetor të

viti 2021 ka rritje më të madhe prej 2,41% të depozitave në denar gjithashtu rritje edhe në ato devizore pre prej 1,84%.


Grafikoni 4. Lëvizja e depozitave në denar dhe devizë në vitin 2020 (në një mijë denar)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Depozita në denar në depozitat në përgjithshme të popullatës deri më 31.12.2021 paraqesin 49,2%, për kundrejt 50,8% të depozitave të përgjithshme devizore (pjesëmarrje më e madhe në tre vitet e fundit dhe atë mbi 50%) në depozitat e përgjithshme të popullatës (Grafikoni 5).


Grafikoni 5. Pjesëmarrje e depozitave të përgjithshme të popullatës në deviza dhe atyre në denar gjatë vitit 2021 (në përqindje)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Sipas afatizimit, depozitat e paafatizuara kanë rritje prej 18,7% ndërsa ata të afatizuarat kanë rënie prej (-4,18%) krahasuar me vitin 2020. (Grafikoni 6).


Grafikoni 6. Lëvizja e depozitave të paafatizuara dhe afatizuara në vitin 2021
(në një mijë denar)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pjesëmarrje e depozitave të përgjithshme të popullatës të paafatizuara më 31.12.2021 paraqet 54,6%, ndërsa pjesëmarrja e depozitave të afatizuara në depozita e përgjithshme të popullatës deri më 31.12.2021 paraqet 45,4%. Në Grafikonin nr.7 është paraqitur pjesëmarrja e depozitave të paafatizara dhe atyre të afatizuara të depozitave të përgjithshme të popullatës në tre vitet e fundit: 2019, 2020 dhe 2021.


Grafikon 7. Paraqitja e depozitave të paafatizuara dhe afatizuara në depozitat e përgjithshme të popullatës në vitin 2019, 2020 dhe 2021
(në përqindje)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Vlera(shuma) e kompenzimit në pajtim me Ligjin e Fondit për Sigurimin e Depozitave është 30.000 euro në kundërvlerë me denarin për një depozitues për bankë ose shtëpi kursimi. Në Shtojcën nr. 1 të këtij raporti janë treguar lëvizjet tremujore të depozitave të përgjithshme të popullsisë të klasifikuara sipas pragut ligjor për kompenzim në vlerë prej 1,85 milion denar ose 30.000 euro në kundërvlerë me denarin. Analiza e depozitave të popullatës në pajtim me shumën e kompenzimit tregon se pjesëmarrja e **depozitave të siguruara** të popullatës në depozitat e përgjithshme është më e madhe në tremujorin e dytë të vitit 2021 dhe atë me 72,51% , ndërsa më e ulët në tremujorin e katërtë të vitit 2021 me vlerë prej 70,76%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **deri në 30.000 euro** në depozitat e përgjithshme më e madhe është në tremujorin e dytë të vitit 2021 me 54,53% ndërsa më e ulët në tremujorin e katërtë të 2021 me 52,77%,15%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës në vlerë **mbi 30.000 euro** në depozitat e përgjithshme është më e lartë në tremujorin e katërtë të vitit 2021 me 47,15% , ndërsa më e ulët në tremujorin e dytë të vitit 2021 me vlerë prej 45,43%. (Grafikoni 8)

Grafikoni 8. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në depozitat e **përgjithshme të popullatës** (IVQ.2020 – IVQ.2021)
(në përqindje)




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

---- deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin

---- mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin

Depozitat e popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin analizohen veç e veç sipas bankave dhe shtëpitë e kursimit, dhe duke u nisur prej këtu depozitat e popullatës **deri në 30.000 euro nëpër banka** në depozitat e popullatës nëpër banka është më e madhe në tremujorin e dytë të vitit 2021 me 54,27% ndërsa më e ulët në tremujorin e katërtë të vitit 2021 në 52,53%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **mbi 30.000euro në kundërvlerë me denarin në banka** në depozitat e përgjithshme të popullatës në banka është më e lartë në tremujorin e katërtë të vitit 2021 dhe atë me 47,08%, ndërsa më e ulët në tremujorin e dytë të vitit 2021 me 45,36% (Grafikoni 9).

Grafikoni 9. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin **në banka** depozitat e përgjithshme të popullatës në banka -anëtare të FSD (IVQ.2019 – IVQ.2020)




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

---- deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin

---- mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin

Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **deri në 30.000 euro në shtëpi të kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullatës në shtëpitë e kursimit është më e madhe në tremujorin e dytë të vitit 2021 me 78,3%, ndërsa më e ulët në tremujorin e katërtë të vitit 2021 me 75,39%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në shtëpitë e kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullsisë është më e lartë në tremujorin e katërtë të vitit 2021 dhe paraqet 24,61%, ndërsa më e ulët në tremujorin e dytë të vitit 2021 me 21,70% (Grafikoni 10).

Grafikoni 10. . Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin **në shtëpi të kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullsisë në kursimore -anëtare të FSD (IVQ.2019 – IVQ.2020)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

---- deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin


---- mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin

Pagesa e premive në vitin 2021 zhvilloheshte sipas procedurave të rregullta, me normë të përcaktuar prej 0,25% në nivel vjetor.

Mjetete e përgjithshme të cilat iu paguan Fondit në vitin 2021 në bazë të premisë paraqesin 754,7 milion denar ose 12,3 milion euro (Grafikoni 11).

Grafikoni 11. Lëvizja e shumës mujore të premive në vitin 2021


(në denar)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Norma e mbulimit të depozitave të popullatës(mjetet e përgjithshme të Fondit në lidhje me depozitat e përgjithshme të popullatës) në dhjetor të vitit 2021 paraqet 4,8% dhe është mbi minimumin prej 4%. Gjatë viti 2021 norma e mbulimit është më e lartë në janar me 4,95%, ndërsa më e vogël në dhjetor të vitit 2021 me 4,80%. Trendi i rënies së normës së mbulimit i cili filloi në vitin 2021 për arsye të uljes së mjeteve të përgjithshme të Fondit për Sigurimin e Depozitave të cilat ishin të nevojshme për pagesën e kompensimeve të depozitorëve të „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim (Grafikoni 12).

Grafikoni 12. Lëvizja e normës së mbulimit në vitin 2021
(në përqindje)




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

II. PORTOFOLI INVESTUES I FONDIT (01.01.2021– 31.12.2021)

Më 31.12.2021 gjendja e përgjithshme e portofolit investues paraqiste 14.770 milion denar sipas vlerës së tyre nominale, gjegjësisht 14.730 milion denar vlera e tanishme. Në nivel vjetor shënon rritje prej 807,5 milion denarësh gjegjësisht rritje prej 5,8% krahasuar me gjendjen e portofolit investues më 31.12.2020. Në lidhje me gjendjen e planifikuar të plasmanit të bonove të thesarit shtetëror për fundin e vitit 2021 (14.670 milion denar, vlerë nominale), indeksi paraqet 100,7% gjë që tregon se mjetet e Fondit janë investuar në mënyrë të drejtë në lidhje me bonot e thesarit të cilat u planifikuan për vitin 2021, indeksi i bonove të thesarit është identik me rritjen minimale në lidhje me atë të planifikuarën prej 0,7% . (Grafikon 13)

Grafikoni 13. Portofoli investues i Fondit në bono të thesarit shtetëror për vitin 2021

(në një mijë denar)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

___ Plani i PI _____ PI i realizuarLinear (PI i realizuar)

Fondi morri pjesë në gjithsej 14 aukcione të bonove të thesarit të Ministrisë së Financave, në pajtim me politikën investuese të Fondit për Sigurimin e Depozitave shuma e përgjithshme e portofolit investues të Fondit nuk kaloi 99,00% nga totali i gjendjes së mjeteve të përgjithshme dhe gjendjes së letrave me vlerë të Fondit në fund të çdo muaji, ndërsa më 31.12.2021 ky raport paraqite 96,8%.

Portofoli investues i Fondit në fund të vitit është i përbër nga bono thesari me afat maturimi prej 364 ditësh. Në mënyrë shtesë , në këtë periudhë kishte edhe ndryshim të normave të interesit gjegjësisht normë interesi të bonove me afat maturimi deri në 364 ditë e cila ishte 0,4% dhe 0,5% në nivel vjetor deri në muajin tetor të vitit 2021, me çka u rritë në 0,7%. Të ardhurat totale të Fondit në bazë të kamatës nga bonot e reja të thesarit për vitin 2021 paraqesin 30,4 mijë denar. Shpenzimet për provizion për bankat ndërmjetsuese të aukcioneve paraqet 525 mijë denar.

Tabela 2. Pasqyrë e dinamikës së bonove të thesarit shtetëror të planifikuara, të reja dhe normat e interesit për të njejtat për periudhën prej 01.01.2021 deri 31.12.2021 (në denar)

2021/mесеци	Нови државни записи (ДЗ) во периодот јануари-декември 2021 (во номинален износ)			Планирани државни записи (ДЗ) во периодот јануари-декември 2021 (во номинален износ)			Разлика во номинален износ 4-6	Индекс 4/6	Камата за новите државни записи			Провизија
	датум на уплата	датум на достасување	нови ДЗ	датум на достасување	достасани ДЗ	планирани ДЗ			каматна стапка (%)	камата до достасување	камата до 31.12.2021	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		
јануари			600.000.000		531.920.000	520.000.000	80.000.000	115,4%		2.416.800	2.244.170	35.000
	27.01.2021	26.01.2022	600.000.000	27.01.2021	531.920.000	520.000.000			0,40	2.416.800	2.244.170	35.000
февруари	10.02.2021	09.02.2022	760.000.000	10.02.2021	699.510.000	760.000.000	0	100,00%	0,40	3.061.280	2.724.872	35.000
март			3.690.000.000		3.584.800.000	3.650.000.000	40.000.000	101,10%		14.863.320	12.171.093	70.000
	03.03.2021	02.03.2022	3.040.000.000	03.03.2021	2.974.800.000	3.040.000.000	0	100,00%	0,40	12.245.120	10.193.054	35.000
	31.03.2021	30.03.2022	650.000.000	31.03.2021	610.000.000	610.000.000	40.000.000	106,56%	0,40	2.618.200	1.978.039	35.000
април			1.230.000.000		1.200.000.000	1.270.000.000	-40.000.000	96,85%		4.954.440	3.552.497	35.000
	14.04.2021	13.04.2022	1.230.000.000	14.04.2021	1.200.000.000	1.270.000.000	-40.000.000	96,85%	0,40	4.954.440	3.552.497	35.000
мај			1.040.000.000		970.000.000	1.030.000.000	10.000.000	100,97%		5.231.200	3.348.542	35.000
	12.05.2021	11.05.2022	1.040.000.000	12.05.2021	970.000.000	1.030.000.000			0,50	5.231.200	3.348.542	35.000
јуни	16.06.2021	15.06.2022	520.000.000	16.06.2021	456.780.000	520.000.000	0	100,00%	0,50	2.615.600	1.422.770	35.000
јули	14.07.2021	13.07.2022	60.000.000		0	0	60.000.000		0,50	301.800	140.952	35.000
август	04.08.2021	03.08.2022	60.000.000		0	130.000.000	-70.000.000	46,15%	0,50	301.800	123.540	35.000
септември	15.09.2021	03.08.2022	320.000.000	15.09.2021	249.480.000	310.000.000	10.000.000	103,23%	0,50	1.424.640	473.405	35.000
октомври			2.280.000.000		2.210.000.000	2.280.000.000	0	100,00%		11.468.400	2.187.221	70.000
	13.10.2021	12.10.2022	720.000.000	13.10.2021	660.000.000	720.000.000	0	100,00%	0,50	3.621.600	786.007	35.000
	27.10.2021	26.10.2022	1.560.000.000	27.10.2021	1.550.000.000	1.560.000.000	0	100,00%	0,50	7.846.800	1.401.214	35.000
ноември	17.11.2021	16.11.2022	2.170.000.000	18.11.2021	2.100.000.000	2.170.000.000	0	100,00%	0,50	10.915.100	1.319.408	35.000
декември			2.040.000.000		1.960.000.000	2.030.000.000	10.000.000	100,49%		12.319.140	736.897	70.000
	01.12.2021	30.11.2022	1.010.000.000	01.12.2021	940.000.000	1.010.000.000	0	100,00%	0,50	5.080.300	418.706	35.000
	15.12.2022	14.12.2022	1.030.000.000	15.12.2021	1.020.000.000	1.020.000.000	10.000.000	100,98%	0,70	7.238.840	318.191	35.000
Вкупно:			14.770.000.000		13.962.490.000	14.670.000.000	100.000.000	100,7%		69.873.520	30.445.367	525.000

Burimi : Të dhëna administrative të FSD

III. KOMPENSIMI I DEPOZITUESVE TË ANËTAREVE TË FONDIT TEK TË CILËT KA NDODHUR RAST I RREZIKUT (FALIMENTIM OSE LIKUIDIM)

Kompensimi i depozituesve tek anëtarët e Fondit tek të cilët ka ndodhur rast i rrezikut (falimentim ose likuidim) është një nga tre aktivitetet themelore afariste të Fondit.

Që nga themelimi i Fondit në janar të viti 1997 deri më 31.12.2020 kanë ndodhur gjithsej 12 raste me rrezik. Përlllogaritja e përgjithshme për kompensim nga dymbëdhjetë ish anëtarët e Fondit është 5,7 miliardë denarë. Nga viti 1997 deri më 31.12.2021 janë kompensuar gjithsej 32,504 depozitues në vlerë të përgjithshme prej 5,13 miliardë denarë, që paraqet 90,05% të detyrimeve të paguara nga FSD për kompensim ndaj depozituesve. Pjesa tjetër prej 9,95% paraqet obligim për kompensim në vlerë të përgjithshme prej 0,6 miliardë denarë (Tabela 3).

Gjatë vitit 2021 vazhdoi pagesa e komenzimeve të depozitorëve të "Eurostandard Bankës" SHA Shkup, e cila filloi më 15.09.2020, u realizua nëpërmjet katër bankave paguese: Komerciallna Bankë SHA Shkup, Stopanska Bankë SHA Shkup, NLB Bankë SHA Shkup dhe Halk Bankë SHA Shkup. Në tabelën numër 4 është paraqitur pagesa e depozitorëve me të drejtë kompenzimi të "Eurostandard Banka" SHA Shkup në falimentim, nga fillimi i pagesës më 19.09.2020 deri më 31.12.2021.

Analiza e shumave të paguara të kompensimit sipas shumës së depozitave tregon se përqindja më e madhe prej **98,05%** e depozitave të paguara i takojnë depozitave në vlerë prej 1.200.001-1.850.889 denarë (≈20.000 deri në 30.000 euro), d.m.th. deri në pragun maksimal të kompensimit, **94,68%** për depozitat në vlerë prej 600,001-1,200,000 (≈10,000 deri në 20,000 euro), **89,57%** për depozitat në vlerë prej 300,001-600,000 deri (5,000 deri në 10,000 euro), depozita në vlerë prej 100.001-300.000 denarë (≈1.500 deri në 5.000 euro), **72,05%** të depozitave në vlerë prej 60.001-100.000 denarë (≈1.000 deri 1.500 denarë), **63,36%** të depozitave në vlerë prej 30.001-60.000 denar (≈500 deri 1.000 euro), **47%** të depozitave në vlerë prej 20.001-30.000 denarë (≈320 deri në 500 euro), **36,06%** të depozitave në vlerë prej 10.001 - 20.000 denarë (≈160 deri në320euro)**17,93%**. Depozita në vlerë prej 5.001-10.000 denarë (≈80 deri në 160 euro), **8,24%** në depozita në vlerë prej 1.001-5.000 denarë (≈16 deri në 80 euro), **2,21%**, depozita në vlerë prej 501-1.000 denarë(8 deri në 16 euro), **0,98%** e depozitave në vlerë prej 101-500 denarë (≈1,5 deri në 8 euro) dhe **0,24%** e depozitave në vlerë prej 1 - 100 denarë (≈0,1 deri në 1,5 euro). Sa më të vogla të jenë shumat e depozitave, aq më e ulët është përqindja e depozitave të paguara në kategorinë përkatëse. Pagesa më e ulët është në kategoritë deri në 20.000 denarë. Gjegjësisht, **69.598 depozitues të papaguar** i përkasin kategorisë 1 - 100 denarë (≈0.1 deri në 1.5 euro), 20.799 depozitues të papaguar në kategorinë 101-500 denarë, 8.274 depozitues të papaguar në

kategorinë 501-1.000 denar, 16.268 depozitor të papaguar nga kategoria 1.001-5.000 denarë, 6.664 depozitues të papaguar nga kategoria 5.001-10.000 denarë dhe 4.359 depozitues të papaguar në kategorinë 10.001-20.000 denarë.

Ashtu si edhe më parë, përvoja tregon se depozituesit nuk janë të interesuar të realizojnë të drejtën e tyre për kompensim nëse bëhet fjalë për vlera jotërheqëse të kompensimit.

Përveç pagesës së kompensimit përmes katër bankave pague, Fondi punon edhe në pagesën e trashëgimisë nga depozitor të cilët kanë ndërrur jetë. Gjithashtu, bëhet këthmi i mjeteve në Fondin për Sigurim Penzional dhe Invalidor dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, këthim mjeteve që kanë të bëjnë me persona të cilët kanë ndërruar jetë të cilën nuk kanë qenë të paraqitur me kohë për çlajmërim nga sistemi i tyre dhe në mënyrë jo të drejtë u janë paguar mjete në llogarit e tyre transaksionale në „Eurostandard Bankë” SHA Shkup në falimentim. Gjatë vitit 2021 janë përpunuar mëtepër se 250 raste të pagesës nëpërmjet Fondit.

Në vitin 2021, Fondi për Sigurimin e Depozitave, në rolin e kredituesit me të drejtë prioritare në pagesë, morri pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit të kredituesëve të „Eurostandard Bankë” SHA Shkup në falimentim.

Më 25.05.2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të neneve 110 dhe 112 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nenit 70 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 70/1992 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 202/2019 , 256/2020 dhe 65/2011) solli Vendim me të cilin e shfuqizon nenin 163 paragrafi 3 të Ligjit për banka („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 67/2007, 90/2009, 67/2010, 26/2013, 15/2015, 153/2015, 190/2016, 7/2019 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/2019).

Me këtë Vendim të Gjykatës Kushtetuese, Fondi për Sigurimin e Depozitave e humbi të drejtën prioritare të pagesës (këthimin e mejetve) së kërkesave të tij nga tryeza e falimentuese e bankës ose kursiomores për të cilën është hapur procedurë falimentimi ose likuidimi.

Në vazhdim të këti procesi, më 7 korrik të vitit 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 28 paragrafi 2 dhe 3 dhe neni 71 i Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 70/1992, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 202/2019 , 256/2020 dhe 65/2011) në mbledhjen e mbajtur më 7 korrik të viti 2021, solli Aktvendim për rrëzimin e iniciativës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 163 paragrafi 3 i Ligjit për banka („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 67/2007, 90/2009, 67/2010, 26/2013, 15/2015, 153/2015, 190/2016, 7/2019 dhe 101/2019) sepse për të njëjtën tani më ishte vendosur, si dhe Aktvendim për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 17 të Statutit të Fondit për Sigurimin e Depozitave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”

nr. 46/2001, 68/2002, 31/2003 dhe 69/2003) dhe Vendim për ndryshime dhe plotësime të Statutit të Fondit për Sigurimin e Depozitave, numër 02-312/1-2011 të datës 22.12.2011, numër 02-176/1 të datës 26.06.2014 dhe nr. 02-94/1 të datës 10.02.2015.

Me këtë Aktvendim të Gjykatës Kushtetuese, Fondit për Sigurimin e Depozitave nuk mund t'i mohohet e drejta e cilësisë së kredituesit, është e pakontestueshme se Fondi është në cilësi të barabartë me kreditorët e tjerë në procedurën e falimentimit ose likuidimit të një banke ose kursimorje. Deri më 31.12.2021, Fondi për Sigurimin e Depozitave nuk i është realizuar asnjë pagesë nga kërkesa e tij që ka ndaj „Eurostandard Bankë” në falimentim.

Tabela 3. Pasqyrë tabelare e kompensimit të paguar të depozituesve të anëtarëve të Fondit tek të cilët ka ndodhur rast i rrezikuar nga formimi i FSD deri më 31.12.2021 (në denarë)

Ред. бр.	Име на банка/штедилница каде настанал ризичен настан	Датум на почеток на исплата на обесштетување	Вкупни депозити	Пресметано обесштетување		Исплатено обесштетување		Процент на пресметано обесштетување во однос на вкупни депозити	исплатено/пресметано		Неисплатено обесштетување	
				Износ	Депоненти	Износ	Депоненти		Процент на исплатени депоненти во однос на вкупен број на депоненти за обесштетување	Износ	Депоненти	
1	2		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Експорт импорат банка а.д. Скопје	29.03.2007	106.227.033	95.608.486	1.166	92.386.606	606	90,00	96,63	51,97	3.221.880	560
2	Митштедилница - Куманово	10.07.2003	6.790.124	6.769.326	56	6.767.552	33	99,69	99,97	58,93	1.774	23
3	Штедилница ИНКО д.о.о. Скопје	22.09.2010	11.927.740	11.771.613	60	11.630.312	39	98,69	98,80	65,00	141.301	21
4	Алмако банка а.д. Скопје	18.08.2000	2.850.307	1.784.964	721	381.205	10	62,62	21,36	1,39	1.403.759	711
5	Македонска банка а.д. - Скопје	04.12.2007	1.543.168.575	1.304.590.349	115.121	1.164.277.506	18.321	84,54	89,24	15,91	140.312.842	96.800
6	А.Д. Радобанк Скопје	25.08.2005	86.224.736	76.005.556	3.629	72.412.381	785	88,15	95,27	21,63	3.593.175	2.844
7	Штедилница Киро Кучук - Велес	15.09.2006	3.351.082	3.318.630	762	3.239.487	186	99,03	97,62	24,41	79.143	576
8	Штедилница Фершпед Д.О.О. Скопје	13.04.2010	6.218	6.218	230	0	0	100,00	0,00	0,00	6.218	230
9	Еуростандард банка АД, Скопје Центар	15.09.2020	5.393.964.397	4.179.607.269	137.111	3.761.309.787	12.424	77,49	89,99	9,06	418.297.482	124.687
10	Штедилница Уни-проком Скопје	01.02.2000	7.881.535	5.118.309	144	4.919.528	79	64,94	96,12	54,86	198.781	65
11	Штедилница Интерфалко д.о.о. - Скопје	19.12.2012	17.832.485	17.832.485	62	17.824.557	21	100,00	99,96	33,87	7.928	41
	Вкупно		7.180.224.229	5.702.413.202	259.062	5.135.148.920	32.504	79,42	90,05	12,55	567.264.281	226.558
	Вкупно во евра		116.511.014	92.531.085		83.326.284					9.204.801	

Tabela 4: Pasqyrë tabelare e kompensimit të llogaritur, të paguar dhe të papaguar të depozituesve nga Eurostandard Baka SHA Shkup në falimentim në periudhën nga 15.09.2020 deri më 31.12.2021

Висина на обесштетување	Пресметано обесштетување		Исплатено обесштетување			Неисплатено обесштетување		
	Вкупен број на Потврди	Вкупен износ на пресметано обесштетување	Број на исплатени Потврди	Вкупен износ на исплатено обесштетување	Процент на исплатено обесштетување во споредба со пресметаното обесштетување	Број на неисплатени Потврди	Вкупен износ на неисплатено обесштетување	Процент на неисплатено обесштетување во споредба со пресметаното обесштетување
Износ на депозити во денари до праг на обесштетување од 30.000 евра во денарска противвредност								
1.850.890-99.999.999	0	0	0	0	0,00	0	0	0,00
1.200.001-1.850.889	1.315	2.233.723.760	1.290	2.190.097.351	98,05	25	43.626.409	1,95
600.001-1.200.000	901	754.296.107	851	714.165.025	94,68	50	40.131.082	5,32
300.001-600.000	975	409.167.485	869	366.505.254	89,57	106	42.662.231	10,43
100.001-300.000	2.003	346.976.579	1.609	281.746.357	81,20	394	65.230.222	18,80
60.001-100.000	1.453	112.442.665	1.022	81.018.136	72,05	431	31.424.529	27,95
30.001-60.000	2.827	117.495.918	1.779	74.448.362	63,36	1.048	43.047.556	36,64
20.001-30.000	1.675	40.958.999	784	19.250.857	47,00	891	21.708.142	53,00
10.001-20.000	4.359	60.302.108	1.531	21.743.988	36,06	2.828	38.558.120	63,94
5.001-10.000	6.664	47.551.796	1.146	8.528.338	17,93	5.518	39.023.458	82,07
1.001-5.000	16.268	43.966.780	1.117	3.622.002	8,24	15.151	40.344.778	91,76
501-1.000	8.274	5.888.500	168	130.327	2,21	8.106	5.758.173	97,79
101-500	20.799	5.070.719	162	49.492	0,98	20637	5.021.227	99,02
1-100	69.598	1.765.853	96	4.298	0,24	69.502	1.761.555	99,76
Вкупно:	137.111	4.179.607.269	12.424	3.761.309.787	89,99	124.687	418.297.482	10,01
во евра		67.821.041		61.033.472			6.787.568	

Burimi : Të dhëna administrative të Fondit

IV. REZULTATET FINANCIARE PËR VITIN 2021

Rezultatet financiare të realizuara për periudhën 01.01 - 31.12.2021

Gjatë vitit 2021, Fondi i Sigurimit të Depozitave realizoi rezultatet e poshtëshënuara financiare:

Tabela 5. Rezultatet financiare të Fondit për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021
(në denarë)

Përshkrimi	
Të ardhurat	62.678.928
Shpenzimet	16.707.852
Fitimi bruto	46.971.076
Tatimi mbi fitimin	4.721.252
Fitimi neto	42.249.824

Burimi : Të dhëna administrative të Fondit

Tabela 6. Gjendja e mjeteve dhe detyrimeve të Fondit më 31.12.2021

(në denarë)

Përshkrimi	
Mjetet	15.238.039.162
Mjetet jomateriale	0
Mjetet materiale	19.100.763
Investime	14.730.822.442
Paratë e gatshme	485.055.373
Të arkëtueshme	3.060.584
Kapitali, rezervat dhe detyrimet	15.238.039.162
Kapitali	10.299.958
Rezervat e sigurisë	14.768.533.400
Fitimi i akumuluar	42.249.824
Detyrimet për dëmet	416.883.993
Detyrime të tjera afatshkurtra	71.987

Burimi : Të dhëna administrative të Fondit

Gjendja e bilancit të Fondit për Sigurimit e Depozitave më 31.12.2021

(në mijëra denarë)

Përshkrimi	Gjendja 31.12.2020	%	Plani 31.12.2021	%	Gjendja 31.12.2021	%	Indeksi 6/2	Indeksi 6/4
1	2	3	4	5	6	7	8	9
MJETE	14.645.390	100,00	15.078.036	100,00	15.238.039	100,00	104,05	101,06
Mjetet jo-materiale	0	0,00	0	0,00	0	0,00		
Softver dhe të drejta të ngjajshme	0	0,00	0	0,00	0	0,00		
Mjetet matariale	19.843	0,14	19.516	0,13	19.101	0,13	96,26	97,87
Pasuri të paluajtshme	19.453	0,13	18.779	0,12	18.645	0,12	95,85	99,29
Pajisje	390	0,00	737	0,00	456	0,00	116,92	61,87
Investime	13.930.549	95,12	14.638.930	97,09	14.730.822	96,67	105,74	100,63
Bono dymbëdhjetë mujore	13.930.549	95,12	14.638.930	97,09	14.730.822	96,67	105,74	100,63
Para të gatshme, arkëtime, përkufizime	694.998	4,75	419.590	2,78	488.116	3,20	70,23	116,33
Para të gatshme	678.376	4,63	415.308	2,75	485.056	3,18	71,50	116,79
1. Para të gatshme në banka	678.291	4,63	415.238	2,75	485.000	3,18	71,50	116,80
2. Para të gatshme, mjete të dedikuara (destinuara)	70	0,00	60	0,00	35	0,00	50,00	58,33
3. Arkë	15	0,00	10	0,00	21	0,00	140,00	210,00
Arkëtime	16.622	0,11	4.282	0,03	3.060	0,02	18,41	71,46
1. Arkëtim me bazë premi	11.596	0,08	0	0,00	0	0,00	0,00	
2. Arkëtime të tjera	0	0,00	0	0,00	0	0,00		
3. akonotacione(shkurtesa) e tatimit mbi fitimin	5.026	0,03	4.282	0,03	3.060	0,02	60,88	71,46
Përkufizimet	0	0,00	0	0,00	0	0,00		
1.ABP	0	0,00	0	0,00	0	0,00		
KAPITALI DHE REZERVAT DHE DETYRIMET	14.645.390	100,00	15.078.036	100,00	15.238.039	100,00	104,05	101,06
Kapitali dhe rezervat	14.024.166	95,76	14.827.201	98,34	14.821.083	97,26	105,68	99,96
Kapitali i paguar	10.300	0,07	10.300	0,07	10.300	0,07	100,00	100,00
Fondi i sigurimit	13.943.672	95,21	14.781.434	98,03	14.768.533	96,92	105,92	99,91
Fitimi për vitin	70.194	0,48	35.467	0,24	42.250	0,28	60,19	119,12
Detyrimet rrjedhëse	621.224	4,24	250.835	1,66	416.956	2,74	67,12	166,23
Detyrimet për dëmet	621.156	4,24	250.835	1,66	416.884	2,74	67,11	166,20
Detyrime të tjera	68	0,00	0	0,00	72	0,00	105,88	
1. Detyrime të tjera afatshkurtra	68	0,00	0	0,00	72	0,00	105,88	
2.ΠBP	0	0,00	0	0,00	0	0,00		

Burimi : Të dhëna administrative të Fondit

**Bilansi i suksesit të Fondit për Sigurimin e Depozitave
për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021**

(në mijëra denarë)

Përshkrimi	Gjithsej 01.01.2020 -	%	Plani 01.01.2021 -	%	Gjithsej 01.01.2021 -	%	Indeksi 6/2	Indeksi 6/4
	31.12.2020		31.12.2021		31.12.2021			
1	2	3	4	5	6	7	8	9
TË ARDHURAT (të hyrat)	95.522	100,00	60.279	100,00	62.679	100,00	65,62	103,98
1. Bono thesari -dymbëdhjetë mujore	95.485	99,96	60.269	99,98	62.641	99,94	65,60	103,94
2. Interes ndëshkues në bazë të premive	24	0,03	10	0,02	38	0,06	158,33	380,00
3. dallime pozitive të kursit	13	0,01	0	0,00	0	0,00	0,00	
TË DALAT (SHPENZIMET)	17.507	100,00	20.861	100,00	15.708	100,00	89,72	75,30
1. Shpenzime për shërbime	830	4,74	2.466	11,82	880	5,60	106,02	35,69
2. Amortizimi dhe zhvlerësimi	1.289	7,36	1.014	4,86	938	5,97	72,77	92,50
3. Shpenzime materiale	493	2,82	864	4,14	630	4,01	127,79	72,92
4. Shpenzime të tjera për punë	1.247	7,12	1.747	8,37	1.325	8,44	106,26	75,84
5. Shpenzime për të punësuarit	10.602	60,56	14.315	68,62	11.405	72,61	107,57	79,67
6. Shpenzimet në bazë të investimeve financiare	3.046	17,40	455	2,18	530	3,37	17,40	116,48
Fitim bruto	78.015		39.418		46.971		60,21	119,16
Tatim mbi fitimin	7.821		3.950		4.721		60,36	119,52
Fitimi neto	70.194		35.468		42.250		60,19	119,12

Burimi : Të dhëna administrative të Fondit

V. AKTIVITETET AFARISTE TË FONDIT GJATË VITIT 2021

ORGANET E MENAXHIMIT DHE UDHEHEQJA

Organet drejtuese të Fondit përbëhen nga Bordi i Drejtues dhe Drejtori.

Përbërja e Bordit Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimit të Depozitave janë:

- Suzana Peneva - anëtare e BD me propozim të Ministrisë së Financave, kryetare e Bordit Drejtues të Fondit për Sigurimin e Depozitave;
- Lençe Tagasovska – u.d anëtare e BD me propozim të Ministrisë së Financave;
- Magdalena Simonovska - anëtare e BD me propozim të Ministrisë së Financave;
- Nora Manova - Trajkovska – u.d anëtare e BD me propozim të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Milena Perçinkova – u.d anëtare e BD me propozim të Shoqatës së Bankave të Maqedonisë.

Me Aktvendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 04.08.2021, anëtar i Bordit Drejtues në Fondin e Sigurimit të Depozitave, nga ana e Ministrisë së Financave në vend të Lençe Tagasovës është emruar Olivera Neçkovska, ndërsa më 30.11.2021, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vend të Nora Manova-Trajkovskës emëroj Melita Nikodinovskën.

AKTET E SJELLURA

Në vitin 2021 janë mbajtur 12 mbledhje të Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimit të Depozitave, edhe atë nga mbledhja e 28 deri në mbledhjen e 39 .

Vendimet më të rëndësishme që janë sjellur gjatë kësaj periudhë janë:


- Vendim për miratimin e Raportit për regjistrimin e realizuar të pasurisë dhe detyrimeve të Fondit të Sigurimit të Depozitave më datë 31.12.2020.;
- Vendim për shpërndarjen (shlyerjen) e mjeteve bazë të Fondit për Sigurimin e Depozitave;
- Vendim për shërndarjen (shlyerjen) e inventarit të vogël të Fondit të Sigurimit të Depozitave;
- Vendim për miratimin e llogarisë vjetore të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2020;
- Vendim për miratimin e Raportit vjetor të veprimtarisë afariste të Fondit të Sigurimit të Depozitave 2020;
- Vendim për miratimin e Raporteve financiare të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2020;
- Vendim për shpërndarjen e fitimit neto të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2020;
- Vendim për miratimin e e Raportit gjysmë vjetor për aktivitetin afarist të Fondit të Sigurimit të Depozitave për periudhën 01.01.2021 deri 30.06.2021;
- Vendim për miratimin e Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2021;
- Vendim për miratimin e Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2022;
- Vendim për autorizimin e drejtorit të Fondit të Sigurimit të Depozitave për marrjen e vendimeve individuale për portofolin e investimeve të Fondit;

ORGANIZIM TEKNIK DHE KADROVIK

Në gjysmën e parë të vitit 2021 në Fond punojn 12 persona. Organogram i vendeve të punës për vitin 2021 në Fondin për Sigurimin e Depozitave është i treguar në fotografinë nr.1

Fotografia 1. Organogrami i vendeve të punës në Fondin për Sigurimin e Depozitave për vitin 2021

.



Fotografia 2. Procesi afarist në Fondin për Sigurimin e Depozitave



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në cilësi të anëtares me të drejtë të plotë në Forumit Evropian të Sigurimit të Depozitave (EFDI), dhe si njëra nga anëtarët më aktive e Komitetit për Mardhënie me Publikun pran EFDI, Fondi për Sigurimin e Depozitave nga Republika e Maqedonisë së Veriut morri pjesë në të gjithë mbledhjet online të cilat ishin caktuar nga partnerët ndërkombtar.

Për herë të parë që nga paraqitja e shmundjes ngjitëse, nën organizimin e kolegëve tanë nga Fondi i Mbrojtjes së Depozitave, të Malit të Zi, në Budvë më 24 dhe 25 shtator të viti 2021 u mbajtë takim me vendet e rajonit të Ballkanit, me prezencë fizike, Fondi për Sigurimin e Depozitave morri pjesë me prezentimet e veta.

Fotografia 3. Takimi i siguruesëve të depozitave në rajonin e Ballkanit, 25.09.2021, Budva




Burimi: Fondi për Sigurimin e Depozitave

MARDHËNIE ME PUBLIKUN

Fondi për Sigurimin e Depozitave, vazhdimisht publikon njoftime për publikun nëpërmjet veb faqes , nëpërmjet profileve të tij në rrjetet sociale si dhe mediat publike, me anë të të cilëve njofton për rrjedhën e pagesës së komenzimeve të depozitorëve të „ Eurostandard bankë” SHA Shkup, në falimentim.

Fotografia 4. Një pjesë e titujve të dedikuara për Fondin e Sigurimit të Depozitave nëpër medime rreth pagesës së depozitorëve të „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim



Burimi : Veb portale të cilat kanë publikuar njoftime të Fondit për Sigurimin e Depozitave

Më 30.10.2021, me prezencë fizike në pajtim me protokolet e rrepta, u mbajtë ngjarja me të cilën u shënuar Dita botërore e kursimit – 31 tetori. Ky manifestim u organizua nga Asociacioni Bankar Maqedonas, në bashkëpunim me Fondin për Sigurimin e Depozitave. Në këtë manifestim mbajti fjalë Kryetarja e ABM, d-r Maja Stevkova- Shterieva, Ministri i Financave, d-r Fatmir Besimi, guvernatorja e Bankës Popullore, m-r Ana Mitreska dhe drejtori i Fondit, Amir Shabani.


Fotografija 5. Ngjarja me rastin e Ditës botërore të kursimit, 31 Tetori- 30.10.2021




Burimi : Fondi për Sigurimin e Depozitave

Në vitin 2021, Fondi për Sigurimin e Depozitave realizoj edhe dizajnin e ri të veb faqes së vetë www.fodsk.org.mk, nga ku publiku mund të informohet me të gjitha të dhënat në lidhje me punën e Fondit për Sigurimin e Depozitave.

Fotografia 6. Dizajni i ri i veb faqes së Fondit i realizuar në vitin 2021





Me ftesë të Fakultetit Ekonomik nga Shkupi, Fondi për Sigurimin e Depozitave mbajti tre orë ligjërata, studentëve të departamentit Menaxhment financiar, me temë „Fondi për Sigurimin e Depozitave” në suaza të puntorisë PRAKTIKA BALLKANIKE.

Fotografia 7. Ligjërata On-line e Fakultetit Ekonomik, Shkupi i cili u mbajt më 22.12.2021



AKTIVITETE TË TJERA TË FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në Fond gjatë viti 2021 u realizuan edhe furnizime të rregullta publike (sigurim teknik të hapsirës afariste, sigurim të hapsirës publike furnizim me mjete higjenike dhe prodhime të tjera të nevojshme).

Gjatë viti 2022, Fondi do të vazhdoj me realizimin e aktiviteteve të veta të planifikuara.

Наш број 02 – 120/1
Скопје, 25.02.2022 година

Директор/Drejtor
Amir Shabani



Shtojca nr.1 Lëvizja e depozitave të përgjithshme të popullatës nëpër banka dhe kursimore me nivel mbulimi në vitin 2021 sipas tremujorëve
 (në denarë)

	Përshkrim	IVQ 2020	IQ 2021	IIQ 2021	IIIQ 2021	IVQ 2021
Depozita të popullatës nëpër banka	Deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	160.182.880.177,90	162.893.311.832,85	164.527.937.581,93	162.201.657.481,08	166.354.521.289,08
	Mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	134.358.893.930,92	136.669.157.268,29	137.513.396.071,62	144.827.503.258,48	149.071.468.751,64
	Gjithsej	294.541.774.108,82	299.562.469.101,14	302.041.333.653,55	307.029.160.739,56	315.425.990.040,72
	Deri 30.000 euro për kompenzim	53.179.611.060,00	54.030.960.192,00	54.366.867.900,00	55.456.838.772,00	56.780.652.720,00
Numri i kursysëve veç e veç nëpër banka	Deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	2.661.407	2.629.775	2.622.495	2.614.698	2.616.673
	Mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	28.733	29.216	29.374	29.963	30.712
	Gjithsej	2.690.140	2.658.991	2.651.869	2.644.661	2.647.385
	Gjithsej depozita të siguruara	213.362.491.237,90	216.924.272.024,85	218.894.805.481,93	217.658.496.253,08	223.135.174.009,08
Depozita të popullatës nëpër kursimore	Deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	788.969.253,00	784.457.553,00	793.166.429,00	784.638.603,00	753.728.494,00
	Mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	231.778.500,00	238.512.590,00	219.803.441,00	235.575.844,00	246.092.085,00
	Gjithsej	1.020.747.753,00	1.022.970.143,00	1.012.969.870,00	1.020.214.447,00	999.820.579,00
	Deri në 30.000 euro për kompenzim	157.319.700,00	164.593.218,00	151.769.700,00	159.172.584,00	171.939.330,00
Numri i kursysëve veç e veç nëpër kursimore	Deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	32.132	32.203	32.249	32.275	32.333
	Mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	85	89	82	86	93
	Gjithsej	32.217	32.292	32.331	32.361	32.426
	Gjithsej depozita të siguruara	946.288.953,00	949.050.771,00	944.936.129,00	943.811.187,00	925.667.824,00
Gjithsej depozita të popullatës nëpër banka dhe kursimore	Deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	160.971.849.430,90	163.677.769.385,85	165.321.104.010,93	162.986.296.084,08	167.108.249.783,08
	Mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	134.590.672.430,92	136.907.669.858,29	137.733.199.512,62	145.063.079.102,48	149.317.560.836,64
	Gjithsej	295.562.521.861,82	300.585.439.244,14	303.054.303.523,55	308.049.375.186,56	316.425.810.619,72
	Deri në 30.000 euro për kompenzim	53.336.930.760,00	54.195.553.410,00	54.518.637.600,00	55.616.011.356,00	56.952.592.050,00
Numri i kursysëve veç e veç nëpër banka dhe kursimore	Deri në 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	2.693.539	2.661.978	2.654.744	2.646.973	2.649.006
	Mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin	28.818	29.305	29.456	30.049	30.805
	Gjithsej	2.722.357	2.691.283	2.684.200	2.677.022	2.679.811
	Numri i përgjithshëm i depozitave të siguruara	214.308.780.190,90	217.873.322.795,85	219.839.741.610,93	218.602.307.440,08	224.060.841.833,08
Depozitat e përgjithshme të popullatës tek anëtarët e Fondit		295.686.631.000,00	300.706.003.000,00	303.174.255.000,00	308.302.103.000,00	316.667.657.000,00
		14.620.521.128,00	14.751.073.380,00	14.898.545.465,00	15.028.966.677,00	15.215.877.815,00
Niveli i mbulimit	eligible (për sa i përket totalit)	4,95	4,91	4,92	4,88	4,81

Burimi : Të dhëna administrative të Fondit